

Gjuhësia shqiptare përballë asaj ndërkombëtare

Si do të duhej konceptuar togfjalëshi në gjuhësinë tonë?

Mr. Agim Spahiu

13 dhjetor 2003

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori është marrë me çështjen e klasifikimit të togfjalëshave, duke u mbështetur në teoritë gjuhësore të disa gjuhëve të tjera, e në veçanti në atë të gjuhës angleze, mbështetje kjo që për autorin është më e arsyeshme dhe më e mundshme të bëhet edhe në gjuhësinë shqipe. Artikullshkruesi ka sjellë edhe disa shembuj për secilin tip të togfjalëshave në gjuhën shqipe, shpeshherë edhe ndonjë shpjegim teorik-përqasës dhe interpretim edhe nga gjuhë të tjera për arsye thjesht krahasimi.

Nëse mbështetemi në studimet e gjuhësisë së përgjithshme mbi atë që thuhet për **sintagmën** (sidomos në studimet e gjuhëve frankofone përgjithësisht) ose **frazën** (në ato gjermanike), duke filluar nga Sosyr-i, Martine-ja e ndonjë tjetër e deri te gjenerativisti N. Çomski, dhe nëse i marrim ato për bazë a për model, atëherë s'ka dyshim se edhe teoria gjuhësore aktuale mbi togfjalëshin në gjuhësinë tonë do të duhej të pësonte disa ndryshime. Mirëpo ato ndryshime nuk do të jenë aq të mëdha sa të thuhet se i tërë **bazamenti teorik i togfjalëshit** në gjuhën tonë duhet të hudhet poshtë dhe çdo gjë të fillohet nga e para. Madje ka raste kur në këtë teori gjuhësore shumë çështje janë trajtuar e shpjeguar aq mirë, saqë asgjë s'mund t'u heqësh e t'u shtosh. Mirëpo, edhe në studimet e gjuhësisë së përgjithshme nuk mund të thuhet se kjo çështje është konceptuar në mënyrë ideale, ngase edhe në to shpeshherë mund të ndeshim inkonsekuenca, paqartësi e kundërshti të dhënash që dalin madje edhe në të njëjtin studim, e të mos flasim për variantet e studimeve si tërësi, që janë marrë me këtë problematikë. Sido që të jetë, synimet tona janë që të kemi një teori të përbashkët e të njësuar për këtë njësi sintaksore, por duke mos i harruar edhe veçantitë a specifikat e gjuhës sonë.

Studimet mbi togfjalëshin në gjuhësinë botërore i kanë avancuar dhe njësuar në mënyrë të veçantë studiuesit anglezë në deceniet e fundit të shekullit XX. Prandaj, edhe ne do të mbështetemi kryesisht në modelin kësaj gjuhe, por duke mos i lënë anash edhe ato të gjuhëve të tjera.

Nëse mbështetemi në modelin e disa gramatikave të kësaj gjuhe, edhe në gjuhën tonë do të duhej të kishim:

1. Togfjalështa emërorë,
2. Togfjalështa mbiemërorë,
3. Togfjalështa foljorë,
4. Togfjalështa ndajfoljorë, dhe
5. Togfjalështa parafjalorë.

Jashtë këtij klasifikimi do të mbesin **togfjalëshat numërorë e përemërorë**, ngase, me të drejtë, ata i takojnë grupit të togfjalëshave emërorë (konsiderohen si togfjalështa emërorë, meqë disa përemra në gjuhën tonë, si p. sh. ata vetorë, dëftorë, pyetës etj., mund t' i zëvendësojnë emrat, ndërsa numërorët të pashoqëruar me emra, të emëruar, i bartin në vete të gjitha kategoritë gramatikore të emrave, prandaj faktikisht mund të konsiderohen si emra), ndërsa shtohet grupi i togfjalëshave parafjalorë, i cili nuk është marrë në konsiderim nga gjuhësia jonë.

1 Togfjalëshat emërorë

Në gjuhën tonë, pos fjalëve drejtuese emërore (nukleusit) që kanë, (fjalë drejtuese mund të jetë: një emër, një mbiemër i emëruar, një përemër vetor, vetvetor, pyetës, i pacaktuar dhe të gjithë përemrat e tjerë që mund të zëvendësojnë emrat; pastaj numërorët themelorë e rreshtorë të emëruar dhe çdo fjalë tjetër që mund të emërohet) mund të marrin edhe promodifikatorë dhe postmodifikatorë (terma të gjuhësisë angleze që emërtojnë të gjitha shtesat që i paravihen dhe i prapavihen trajtave emërore). Si premodifikatorë mund t' i paravihen të gjithë përcaktorët me përshtatje dhe pa përshtatje, kurse si postmodifikatorë vetëm përcaktorët me drejtim (emrat me e pa parafjalë), disa përcaktorë me përshtatje (siç mund të jenë: mbiemrat e nyjshëm e të panyjshëm, disa përemra dëftorë, pronorë, numërorë rreshtorë;) e përcaktorë të tjerë pa përshtatje (si p. sh. disa ndajfolje e pjesore të zgjeruara, trajta foljore të paskajores e të përcjellores; disa ndërtime frazeologjike), madje edhe ndonjë fjali e nënrenditur përcaktore lidhore e lidhëzore (si p. sh: Njeriu që *vetëm për vete punon*, është si një pemë që frut s' lëshon (Pop.); Lajmi *se do shpërndahet misri*, doli nga zemra e dheut/Migjeni/) etj.

2 Togfjalëshat foljorë

Si premodifikatorë mund t' i marrin foljet ndihmëse: kam e jam; pjesëzat: do të, nuk, s', mos; foljen këpujore jam; foljet gjysmëndihmëse modale: mund, duhet, do, lypset; foljet aspektore: nis, zë, filloj, bëj, vazhdoj, vijoje, pushoj, mbaroj etj., kurse si postmodifikatorë të gjitha trajtat emërore me e pa parafjalë, disa trajta mbiemërore, sidomos ato prejfoljore; disa ndajfolje, sidomos ato të mënyrës e të sasisë; trajtat e pashtjelluara

foljore, e në mjaft raste, edhe fjalitë me nënrenditje ffilluese e rrethore (p. sh.: Dihet që pengesa e parë është gjithmonë e papritur; Shtihej sikur të ishte i vdekur; Iku që të mos kthehej më; Më njoftoni nëse vjen ai.); ndonjë ndërtim frazeologjik (p. sh.: U zhdruk sa të hapësh e të mbyllësh sytë) etj.

3 Togfjalëshat mbiemërorë

Më së shpeshti si premodifikatorë mund të marrin ndajfoljet (si. p. sh.: shumë i ditur, tani i kërrusur, aq i vërtëtshëm etj.), kurse si postmodifikatorë ndonjë emër me fjalëzën krahasuese - si dhe me parafjalë (si p. sh.: e kuqe si molla, e bardhë si bora, i ftohtë si akulli/, por edhe: i ftohtë akull; i lodhur nga udhëtimi, i mahnitur nga bukuritë natyrore, i prirur për muzikë; ndonjë paskajore (p. sh.: i gatshëm për t'u ballafaquar me vështirësitë, i aftë për ta drejtuar mirë atë makinë; etj.). Ndërtimet me paskajore, sa herë që kanë mundësi të zëvendësohen me trajta të lidhore, mund të konsiderohen si ndërtime sinonimike me ndonjë fjali me nënrenditje (si p. sh.: i gatshëm të ballafaqohet me vështirësitë. . . ; i aftë të drejtojë mirë atë projekt; Nga trajta mbiemërore mund të nënrenditet edhe ndonjë fjali e tërë, si: Të bindur (= pasi ishin të bindur) *se një veprim i tillë do të kishte pasojë për të sëmurin*, doktorët morën një varg masash; I pyetur *se kur do të kryhet kjo punë*, ai u përgjegj: ... etj.

4 Togfjalëshat ndajfoljorë

Si premodifikatorë mund të marrin ndonjë ndajfolje sasive (p. sh.: shumë mirë, tepër larg, jashtëzakonisht keq etj.), kurse postmodifikatorë ndonjë emër me parafjalë, (*nesër në mëngjes, diku në themelet e ndërtesës, aty në borë* etj.); madje edhe ndonjë fjali me nënrenditje (p. sh.: Ai, edhe sikur të punojë, më shumë *se ç'merrte*, nuk mund të marrë; Sepse ndryshe *nga ç'mendohej gjer tani*, puna paskish shkua tepër larg; Hija e rëndë e pyllit e sollti natën më herët *nga sa kujtonte vajza*;) etj.

5 Togfjalëshat parafjalorë

Në gjuhën tonë nuk kanë premodifikatorë, por vetëm postmodifikatorë, sepse para emrave dhe foljeve gjithmonë, në raport me to, mbesin si gjymtyrë të varura. Kështu në shembujt: Një studim për pjellorinë e tokës; dhe: Foli për jetën dhe veprën e A. Xhuvanit; togfjalëshi *për pjellorinë e tokës* është përcaktor me drejtim i fjalës *një studim*, kurse *për jetën dhe veprën e A. Xhuvanit* është një kundrinor i zhdrejtë i kallëzuesit *foli*.

Por, në anën tjetër, parafjalët e lokucionet parafjalore mund të kenë reksion mbi ndonjë gjymtyrë emërore dhe më rrallë mbi ato ndajfoljore (p. sh.: *prej këtu*), por ky reksion a drejtim i tyre nuk mund të jetë i atij niveli a shkalle siç mund të jetë, po e zëmë drejtimi i fortë i një foljeje ndaj gjymtyrës emërore ose ndajfoljore. Mirëpo, sido që të jetë edhe vetë parafjala e lokucioni parafjalor mund të sundojë një trajtë emërore a togfjalësh emërorë ose ndonjë trajtë tjetër çfarëdo. Të gjitha këto raste për parafjalën si trajtë që e drejton një emër ose një togfjalësh emëror, mund të konsiderohen si postmodifikatorë. Madje nuk

mungojnë as rastet kur parafjalët e thjeshta e lokucionet parafjalore, së bashku me trajtat emërore a togfjalëshat emërorë, mund të sajojnë fjali të varura, si postmodifikatorë (p. sh.: në vitin *që shkoi*, në javën *që do të vijë*, në dhomën *ku ndodheshin mysafirët*, prej atij momentit *kur ndodhi ajo ngjarje* etj.).

Premodifikatorët dhe postmodifikatorët e këtyre togfjalëshave mund të jenë të llojllojshëm, por natyra e këtij shkrimi nuk na lejon që të zgjerohemi më shumë. Nga klasifikimet e përgjithshme të kësaj njësie sintaksore mund të shihet qartë se togfjalëshat emërorë dhe foljorë janë më kryesoret për të gjitha njësitë kumtuese, ndërsa togfjalëshat mbiemërorë, ndajfoljorë e parafjalorë janë në shërbim të tyre, ose, nëse mund të thuhet, janë **nëntogfjalësha të togfjalëshave të përmendur**.

Të gjithë këta togfjalësha në studimet dhe gramatikat e gjuhës angleze, por edhe në ato të gjuhës gjermane, frënge etj., zakonisht njihen si togfjalësha të përbërë ose me strukturë komplekse. I quajnë kështu, ngase për shumicën e studiuesve ekzistojnë edhe togfjalëshat e thjeshtë ose, thënë ndryshe, togfjalëshat me strukturë minimale¹.

Sa për sqarim do shtuar se **togfjalëshat e thjeshtë ose me strukturë minimale** konsiderohen fjalët e vetme (që kanë një nukleus ose një bërthamë leksikore), së bashku me morfemat e tyre gramatikore (p. sh.: mbaresat e tyre shprehin kuptimet gramatikore të rasës e të shquarësisë a të joshquarësisë tek emrat; të gjinisë e të numrit të mbiemrat dhe të kohës, të vetës, të numrit e pjesërisht të diatezës të foljet; këtu hyjnë pastaj edhe nyjat e pacaktuara e të përparme, ndajshitesat fjalëformuese etj.). Këto vlejné, pra, vetëm për emrat, mbiemrat dhe foljet që i nënshtrohen lakimit (e kanë kategorinë gramatikore të numrit e të gjinisë) e zgjedhimit, ndërsa nuk mund të vlejné për ndajfoljet e parme të tipit si: mirë, keq, lart, poshtë, bukur; sot, sonte, këtu, atje etj., të cilat nuk i kanë kategoritë e përmendura gramatikore (ndonëse disa prej tyre historikisht mund të zberthehen në dy a më shumë pjesë, si p. sh: fjalët *sot, sonte* mendohet të jenë formuar nga togjet: *so dite/këso dite>sot; *so nate/këso nate>sonte etj.), meqë sot konsiderohen si ndërtime të pazbërthyeshme.

Sido që të jetë, togfjalëshat e përbërë ose me strukturë komplekse janë togfjalësha të vërtetë të një gjuhe.

¹Lidhur këta të fundit K. H. Ramers- i në *Einführung in die syntax*, München, f. 27/28, si frazë emërore e konsideron fjalën *das Kind*; si frazë foljore *hustet*, ndërsa si frazë mbiemërore *neu*, Ch. Dürscheid- i në *Syntax, Grundlagen und theorien*, Wiesbaden, 2000, f. 29/30, ka theksuar se *Minimal besteht die Phrase aus einem Wort, dem Kern: So stellt in der Nominalphrase Oma das Wort Oma den Kern und gleichzeitig die gesamte Phrase dar*, e ndonjë tjetër kanë përmendur edhe rastet kur fjalët e vetme janë konsideruar edhe togfjalësha.